

VENDIM
Nr. 88, datë 30.1.2013

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS,
BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, TË OBJEKTIT NR. 2, PJESË E PRONËS
NR. 90, ME EMËRTIM “SHTABI I KML-SË”, ME VENDNDODHJE NË TUFINË,
TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

(Ndryshuar me VKM nr. 169, datë 26.3.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim, pa shpërblim, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Teatrën Kombëtare të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, të objekti nr. 2, me sipërfaqe 458 (katërqind e pesëdhjetë e tetë) m², pjesë e pronës nr. 90, me emërtim “Shtabi i KML-së”, me vendndodhje në Tufinë, Tiranë, prona në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim vendosjen e Ateliesë së Prodhimit të Dekoreve të këtij institucioni, deri më 31 dhjetor të vitit 2017.

2. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Teatrën Kombëtare të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objekteve, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha